



02-03-2018

Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretar@kqz-ks.org Prishtinë - Priština www.kqz-ks.org

Nr./Br. 256-2018

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe nenin 37.2 nën paragrafi (c dhe f) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 02.03.2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z. MILOT DELIU** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Shtime, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës-PDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z.Lumni Amrushi**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet **z.Milot Deliu**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 26.02.2018, nr.229/2018, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Lumni Amrushi, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të emërimit në pozitën e Drejtorit për Kulturë, Rini dhe Sport në Kumnin e Shtimes.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është z.Milot Deliu, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 02.03.2018

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka